

Shqipëria

Raporti i vetëvlerësimit, fundi i periudhës

Plani Kombëtar i Veprimit 2014 – 2016

Lista e shkurtimeve

ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
MMj	Ministria e Mjedisit
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MIAP	Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike
MÇV	Ministri për Çështjet Vendore
MMSR	Ministria e mirëqënies Sociale dhe Rinisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PHQ	Partneriteti për Qeverisje të Hapur
KOSCPQH	Koalicioni i organizatave të shoqërisë civile të partneritetit për qeverisje të hapur

1. Përmbledhje ekzekutive

Që kur Partneriteti për Qeverisje të Hapur nisi në Shtator të vitit 2011, Shqipëria ka treguar përkushtimin e saj përsai takon parimeve themeluese të kësaj nisme dhe vlerave të saj. Deri në fund të vitit 2011, një grup ndërinsitucional pune (GNP) u themelua nga qeveria shqiptare për zhvillimin e planit të veprimit të PQH, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjisë të Antikorrupsionit. GNP udhëhoqej nga Ministri për Inovacionin dhe TIK në atë kohë dhe të gjithë anëtarët e saj ishin zyrtarë të nivelit të lartë nga ministritë e tjera të qeverisjes qendrore dhe të institucionet. Plani i parë i veprimit u hartua gjatë periudhës Janar - Marsit të vitit 2012 dhe u bazua në angazhimet e sjella nga institucionet qeveritare. Organizatat e shoqërisë civile ishin të përfshira dhe mediat (ato të shkruara dhe elektronike) ndihmuan në transmetimin e informacionit në kohë për publikun.

Angazhimet e qeverisë shqiptare adresonin tre nga pesë sfidat e mëdha të PQH: Kritja e integritetit publik, përmirësimi i shërbimeve publike, dhe menaxhimi më efektiv i burimeve publike.

Puna për përgatitjen e PKV të dytë filloi në Janar të vitit 2014, me krijimin e një grupi ndërministror pune të përbërë nga zëvendësministrat e çdo ministri dhe nga drejtorët e institucioneve më të rëndësishme publike dhe agjencive. Ky process u drejtua nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MSHIAP). U formua një grup teknik pune, me përfaqësues nga secila ministri dhe agjenci për të ndjekur në mënyrë periodike hartimin dhe fazat e monitorimit të planit të veprimit.

Në bashkëpunim me shoqërinë civile u organizua për herë të parë një konferencë në Mars të vitit 2015, gjatë të cilit projektangazhimet e çdo ministrie iu shpërndarë grupeve të punës të përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të qeverisë të përfshirë direkt me angazhimet e propozuara.

Në konferencën e KOSCPQH u paraqitën 25 rekomandime lidhur me përmirësimin e PKV-t të dytë. Skedula e aktiviteteve, draft plani i veprimit, 25 rekomandimet dhe secili angazhim u publikuan për konsultim publik në faqen e internetit të MIAP.

Pas konsultimit publik, MIAP organizoi një takim të dytë me shoqërinë civile ku u konsultuan komentet e sugjerimet e ardhura nga shoqëria civile, të cilat u integruan në draft planin e

veprimit. PKV u miratua më tej zyrtarisht nga çdo ministri e përfshirë në këtë proces dhe u publikua në faqen e internetit të PQH.

Të 13 angazhimet e PKV adresonin katër sfida të mëdha të identifikuara nga PQH:

- Rritja e integritetit publik;
- Menaxhimi më efektiv i burimeve publike;
- Përmirësimi i shërbimeve publike;
- Krijimi i komunitete më të sigurta;

Angazhimi	SFIDAT E MËDHA PQH			
	Rritja e integritetit publik	Menaxhim më efektiv të burimeve publike	Përmirësimi i shërbimeve publike	Krijimi i komuniteteve të sigurta
Standartizimi i procesit të ankesave që lidhen me korrupsionin	X			
Regjistri elektronik i autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve të lëshuara nga MEI	X			
Promovimi i vlerave të PQH tek pushteti vendor	X			
Implementimi i modulit të shpenzimeve publike në formatin e të dhënave të hapura	X			

Baza e të dhënave për ndihmën ekonomike		X		
Portal elektronik për menaxhimin e burimeve ujore		X		
“Single Window”		X		
Aksesi elektronik për zonat e mbrojtura			X	
E-Albania			X	
Gjeoportali kombëtar			X	
E-dokumenti			X	
Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve				X
Zyrat e shërbimit të policisë				X

Në 23 Mars 2016, Shqipëria lançoi Forumin e aktorëve të interesit, OpenAlb, një mekanizëm që siguron zbatimin e suksesshëm të PQH në vend. OpenAlb ka një përfaqësim të barabartë të përfaqësuesve zyrtarë të qeverisë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Si e tillë, anëtarët e saj angazhohen në konsultime të rregullta gjatë hartimit të planit të veprimit kombëtar dhe në vlerësimin e rezultateve të arritura nga angazhimet e planit aktual të veprimit.

Ky forum ka për qëllim të sjellë së bashku përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në një tryezë dialogu në mënyrë që të ndërmerren angazhime të rëndësishme për të nxitur reformat në mirëqeverisje. Forumi është i angazhuar për të: promovuar iniciativën e partneritetit të qeverisjes së hapur, konsultuar dhe hartuar planin e veprimit kombëtar dhe monitorimin e zbatimit të angazhimeve me qëllim zgjerimin e praktikës në të gjithë vendin në fushën e transparencës, llogaridhënies dhe angazhimit të qytetarëve.

OpenAlb ka pjesëmarrje të barabartë të institucioneve qeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile. Përfaqësuesit e qeverisë në Forum caktohen në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr, 37, datë 05.02.2014 mbi “Krijimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin dhe ndjekjen e planit të veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur 2014-2016”. Ky grup pune ndërinstitucional kryesohet nga MIAP dhe përbëhet nga çdo zëvendësministër përgjegjës për

planifikimin dhe zhvillimin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të emëruar nga Ministri përkatës në çdo ministri, drejtori i përgjithshëm i AKSHI-t, etj. Ndërsa, përfaqësues të shoqërisë civile në Forum janë anëtarët e KOSCPQH. Këto organizata kanë një histori në angazhimin dhe bashkëpunimin me institucionet qeveritare në kuadër të projektimit, zbatimit dhe vlerësimit të PKA 2014-2016. Forumi është i hapur edhe për të gjithë aktorët e tjerë të shoqërisë civile në Shqipëri.

Ky raport vetëvlerësimi shqyrton progresin e bërë nga qeveria shqiptare deri tani në zbatimin e gjithë planit të veprimit kombëtar për periudhën 2014 - 2016, i dyti plan veprimi për Shqipërinë. Ndërsa jo të gjitha angazhimet e këtij plani janë zbatuar plotësisht, vazhdon puna për t'i finalizuar këto angazhime. Ka pasur gjithsesi zhvillime të rëndësishme në statusin e angazhimeve gjatë vitit të dytë të zbatimit të planit të veprimit në krahasim me vitin paraardhës.

2. Progresi i angazhimeve

1.1 Standartizimi i procesit të ankesave që lidhen me korrupsionin - MÇV

ANGAZHIMI:

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në rolin e Koordinatorit Kombëtar të Antikorrupsionit, do të kryejë standardizimin e procesit në lidhje me ankesat që adresojnë korrupsionin. Aktualisht, edhe pse shumë ministri kanë dhënë dritën jeshile ose kanë mundësuar forma për të denoncuar korrupsionin, nuk ka një procedurë të standardizuar, e cila siguron transparencë në shqyrtimin e ankesës dhe afatet konkrete për të siguruar shërbim të mirë.

STATUSI: I IMPLEMENTUAR




Figura 1: Imazh i kryefaqes të portalit të antikorrupsionit, <http://stat.stopkorrupsionit.al/home/index>

AKTIVITETET:

- Urdhri i Kryeministrit Nr 30, datë 2015/05/03 "Mbi procedurat e unifikuar për trajtimin e ankesave për korrupsion", është miratuar;
- Urdhër aksesohet në faqen zyrtare të kryeministrit dhe MÇV;
- Grupi i zyrtarëve përgjegjës është krijuar dhe është funksional;
- Ankesat janë trajtuar brenda afatit kohor të caktuar;
- Fushata kombëtare për ndërgjegjësimin e publikut për procedurat e reja të raportimit të korrupsionit është hartuar tashmë;

- Hartimi dhe publikimi i raporteve statistikore javore;
- Hartimi dhe publikimi i raporteve mujore për ecurinë e rasteve;

Është arritur përputhshmëria me qëllimet e vëna:

- Hartimi i udhëzimeve përkatëse
- Integrimi i rregullave të transparencës në planet e secilës ministri
- Respektimi i afateve dhe rregullave përkatëse
- Publikimi i standardeve në faqen e internetit

Më 2 Shkurt 2015, qeveria nisi një fushatë mbarëkombëtare për të adresuar çështjen e korrupsionit me moton "Të tregojmë fytyrën e vërtetë të korrupsionit – denonco të padukshme në mënyrë të dukshme!". Elementi kryesor i fushatës ishte krijimi i portalit unik të denoncimit të rasteve të korrupsionit: ëëë.stopkorrupsionit.al, një risi që sjell së bashku në një format të unifikuar, të gjitha portalet e denoncimit të korrupsionit në institucionet e ekzekutivit. Fushata e cila u zhvillua gjatë Dhjetorit të vitit 2015 pritet të rifillojë në tremujorin e 4-rt të vitit 2016 përmes një qasjeje të rigjallëruar duke synuar rritjen e praktikës së denoncimit të korrupsionit në të gjithë vendin, me një shpërndarje gjeografike të përmirësuar të rasteve të raportimit.

Procedurat e unifikuara për trajtimin e ankesave që lidhen me korrupsionim, të cilat janë hartuar dhe miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr 30, datë 5.3.2015, synojnë përveç të tjerash ndërtimin e besimit të publikut, rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies. E reja me këtë portal unik është se rastet janë ndjekur me kujdes nga zyrtarët përgjegjës në institucionet brenda afatit të caktuar dhe qytetarëve informohen për statusin e rastit përkatës. Qytetarët që denoncojnë mund të mbeten anonim.

Për më tepër, i gjithë procesi monitorohet dhe mbështetet nga një sallë operative e cila garanton që të gjitha rastet të ndiqen dhe hetohen në mënyrë profesionale brenda afatit kohor të caktuar. Aktualisht po bëhen të gjitha përpjekjet për të siguruar që funksionet e sallës operative të kalojnë gradualisht nga mbështetja financiare e donatorëve me përballimin e saj nga qeveria qendrore dhe kjo sallë të jetë pjesë e përhershme e strukturës organizative të qeverisë, për të garantuar kështu qëndrueshmëri dhe shërbim të integruar tek qytetarët.

Në këtë drejtim, të gjitha palët e interesuara mund të aksesojnë informacionin në dispozicion të publikut për rastet e korrupsionit të denoncuara që lidhen me institucionet qendrore dhe lokale (pra ministritë dhe bashkitë) dhe në institucionet e tjera të pavarura të nivelit qendror (domethënë: doganat, policia, etj.) përmes burimeve të hapura dhe në kohë reale të informacionit të tilla si ato në portalin: www.stopkorrupsionit.al (p.sh. statisktiakt mund t'i gjeni në: stat.stopkorrupsionit.al/reports~~pobj) ku është mundësuar qasja në të dhënat statistikore dhe përdoruesit e interesuar mund të agregojnë, eksportojnë apo analizojnë statistikatat dhe/ose raportet javore statistikore të publikuara në këtë portal.

T dhëna të tjera në lidhje me vizitat në portal dhe statistika mbi denoncimet, rastet e zgjidhura, ato që janë në proces, etj., mund të gjenden në: <http://stat.stopkorrupsionit.al/home/index>.

Të dhëna nga Portali Stop Korrupsionit.al [raportim deri: 30.06.2016]	
Denoncime në total	14910
Ankesa Administrative	9557
Denoncime për korrupsion	1275
Në shqyrtim	1142
Refuzuar	6568
Zgjidhur	6574
Në prokurori	5
Statistika për aksesin	
Koha mesatare e zgjidhjes se denoncimit	17 ditë
Vizita gjatë vitit 2016	11916
Vizita sipas gjinive	55,9 % meshkuj
	44.1 % femra

Tabela 1: Të dhëna mbi portalin stopkorrupsioni.al portal

1.2 Regjistri elektronik i autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve të lëshuara nga MEI

ANGAZHIMI: *Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në kuadër të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, ka ndërmarrë iniciativën për krijimin e regjistrit elektronik, me qëllim që të krijojë dhe publikojë në faqen e saj të internetit autorizimet, lejet dhe marrëveshjet e dhëna në fushën përkatëse dhe statusin e tyre të përditësuar.*

STATUSI: PJESËRISHT IMPLEMENTUAR

Aktualisht ka një mungesë informacioni jo vetëm në procedurat për marrjen e një autorizimit apo lejeje, por edhe qytetarët, grupet e interesit, shoqëria civile nuk kanë informacion mbi numrin e lejeve dhe autorizimeve të dhëna në sektorin e energjisë dhe të industrisë.

AKTIVITETET:

- Projekti është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 607, datë 6 shtator, 2014;
- Hyrja në fuqi: 27 nëntor 2014;
- Afati i përfundimit të projektit: 30 Dhjetor, 2015;

Deri më tani, ka përfunduar faza e njohjes dhe është miratuar raporti fillestar. Aktualisht MEI është duke punuar për krijimin e Sistemit të Informacionit dhe Monitorimit (MIS) për koncesionet. Pas miratimit nga Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH), do të fillojë faza e dytë.

Regjistri elektronik për koncesionet/lejet/autorizimet udhëhiqet nga Departamenti i Koncesioneve dhe është ende në procesin e implementimit.

Informacioni në lidhje me aspektin legjislativ për procedurat e aplikimit për koncesion, janë të disponueshme në linkun: <http://www.energjia.gov.al/al/baza-ligjore/koncesione/vkm1426776682>

Informacioni në lidhje me aspektin legjislativ për procedurat e aplikimit për koncesion, janë të disponueshme në linkun: <http://www.energjia.gov.al/al/sherbime/lejet-per-koncesionet-minerare> dhe <http://www.energjia.gov.al/al/baza-ligjore/koncesione>

1.3 Implementimi i modullit të pagesave në formatin e të dhënave të hapura – AKSHI

ANGAZHIMI: *Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në kuadër të iniciativës “Partneriteti për Qeverisje të Hapur” ka ndërmarrë si angazhim zbatimin e shërbimeve elektronike të cilat lejojnë aksesimin online të informacionit nga të dhënat buxhetore të Ministrive në formatin “open data”. Shërbimet elektronike janë të aksesueshme nga portali qeveritar e-Albania.*

STATUSI: IMPLEMENTUAR

AKTIVITETET:

Në portalin qeveritar e-Albania, AKSHI ka zbatuar tri shërbime në formatin e “të dhënave të hapura”, një prej të cilave janë shpenzimet publike të pagesave ditore nga Drejtoria e Thesarit. AKSHI dhe Ministria e Financave nëpërmjet këtij shërbimi ofron informacion për përdoruesët, nëpërmjet pagesave të kryera nga Degët e Thesarit në Shqipëri nga viti 2012.

Më poshtë linku: <https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4709>.

Shërbimi i dytë në kuadër të “të dhënave të hapura” është “lista e cmimeve të barnave të rimbursueshme”. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ofrojnë nëpërmjet këtij shërbimi elektronik, për përdoruesit e portalit unik qeveritar e-albania mundësinë e informimit online për çmimet e listës së barnave të rimbursueshme në Republikën e Shqipërisë.

Linku: <https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4707>

Shërbimi i tretë elektronik për “të dhënat e hapura” janë “të dhënat e barnave mjekësore dhe cmimet e tyre”. Nëpërmjet këtij shërbimi përdoruesit e portalit qeveritar e-Albania mund të marrin informacion mbi të dhënat e barnave mjekësore dhe cmimet e tyre, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Linku: <https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4699>

Lidhur me shërbimin elektronik për “Publikimin e pagesave të përditshme” i aksesueshëm në portalin qeveritar e-Albania, ka patur më shumë se 1700 klikime deri në Gusht 2016.

1.4 Promovimi i vlerave PQH midis pushtetit vendor – MIAP, MÇV dhe KOSCPQH

ANGAZHIMI:

MIAP në bashkëpunim me MÇV dhe koalicionit të organizatave të shoqërisë civile të partneritetit pwr qeverisje tw hapur do të ndërmarrin së bashku angazhimin për të promovuar dhe për tw angazhuar autoritetet lokale në vlerat PQH. Ky angazhim u propozua nga organizatat e shoqërisë civile, me qëllim për të prezantuar dhe promovuar vlerat thelbësore të PQH-së edhe në qeverisjen e lokale.

STATUSI: Pjesërisht e implementuar

Ky angazhim është marrë nga MIAP në bashkëpunim me MÇV dhe KOSCPQH. Janë bërë disa përpjekje nga OSHC pjesë të KOSCPQH për ta financuar këtë angazhim përmes thirrjeve të ndryshme për propozim grantesh.

Gjatë muajit Shtator 2015, në bashkëpunim me IDN, njëri prej anëtarëve të OSHC-ve pjesë e KOSCPQH, MIAP, organizoi një event dy ditor mbi dialogun për PQH për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, aktiviteti kishte për qëllim të nxiste qeverisjen gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe transparente dhe politikëbërjen përmes përmirësimit të ekspertizës së shoqërisë civile për të përforcuar dialogun mes shoqërisë civile dhe qeverive në kuadër të PQH.

Në këtë rast, një sesion i veçantë iu kushtua qeverisjes vendore, për atë sesi qeveria lokale dhe OSHC-të mund të punojnë së bashku. Transparenca është themeli i përgjegjësisë lokale; ajo u jep njerëzve mjetet dhe informacionin që ata kanë nevojë për t'u mundësuar atyre të luajnë një rol më të madh në shoqëri. Ky sesion inkurajoi përfaqësuesit e pushtetit lokal dhe OSHC-të që të punojnë së bashku dhe qeverinë që ta shtrijë PQH-në edhe në nivel lokal.

Gjatë muajit Qershor 2016, u mbajt një workshop një ditor i mundësuar nga PQH dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) në ngritjen e kapaciteteve në hartimin e angazhimeve të PQH, monitorimin dhe zbatimin e PKV me pjesëmarrjen ndër të tjerë edhe të përfaqësuesve edhe nga Bashkia Shkodër e cila e vlerësoi pjesëmarrjen në ëorkshop si relevant për iniciativat e tyre lokale.

Bashkia e Tiranës, është një shembull i mirë në drejtim të iniciativave në frymën e vlerave të PQH në vend.

Aplikacioni “Tirana Ime” është një shembull i kësaj: <http://www.tirana.al/aplikacioni-tirana-ime/>

Aplikacioni "Tirana Ime", vjen për të gjithë qytetarët e Tiranës si një udhëzues dixhital për kryeqytetin, me qëllim lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. I dizenuar si një platformë e veçantë dhe lehtësisht e arritshme, "Tirana Ime" përfshin 6 kategori të ndryshme (trafiku, transporti, ndotja, informacione, raporte, turizmi), të cilat vijnë për përdoruesit e telefonave smartphone për të marrë çdo informacion të nevojshëm në kohë reale, kurdo dhe kudo që janë.

Aplikacioni "Tirana Ime" është i disponueshëm falas për të gjithë dhe mund të shkarkohet në Play Store për telefonat Android dhe në App Store për iOS (telefonat iPhone, iPad, and iPod).

Megjithatë, duke qenë se përpjekjet për të promovuar vlerat e PQH midis autoriteteve lokale, nuk kanë përfshirë të gjitha bashkitë e vendit, kjo edhe për shkak të riorganizimit përmes reformës territoriale, ky angazhim është konsideruar si i zbatuar pjesërisht.

2.1 Baza e të dhënave shtetërore për ndihmën ekonomike - MMSR

ANGAZHIMI:

MMSR, në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin Social Shtetëror, në kuadër të reformës për zbutjen e varfërisë, rritjen e transparencës, cilësisë së shërbimit dhe përdorimin efektiv të fondeve buxhetore dhe përjashtimin e rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike, ka ndërmarrë iniciativën për krijimin e Regjistrimit Kombëtar Elektronik të përfituesve të ndihmës ekonomike.

STATUSI: IMPLEMENTUAR

AKTIVITETET:

Sistemi MIS i Ndihmës Ekonomike është ngritur me infrastrukturë tek AKSHI, ai përmban modulet e mëposhtme:

- **Moduli i Administrimit të Sistemit:** administratori i sistemit kryen konfigurimet e nevojshme të përdoruesve, njësitë vendore, zyrat rajonale dhe të drejtat hyrëse të roleve të ndryshme të përcaktuara në sistem.
- **Moduli i Administrimit të Ndihmës Ekonomike:** përdoruesit sipas të drejtave dhe funksioneve që kanë kryejnë të gjitha procedurat në lidhje me aplikimin, verifikimin, vendimin në lidhje me procesin e Ndihmës Ekonomike.

- **Moduli i Brendshëm i Menaxhimit të Dokumenteve:** njësité përgjegjëse mund të protokollojnë, ruajnë, skanojnë dhe kërkojnë dokumentacionin e tyre.
- **Moduli i HelpDesk:** moduli caktimit, raportimit dhe monitorimit të detyrave dhe problemeve nga të gjithë përdoruesit e sistemit.
- **Moduli i Raportimit:** mundëson gjenerimin e raporteve të ndryshme statistikore sipas të drejtave të përdoruesve në sistem. Nga ky sistem nxirren raporte mbi numrin e aplikimeve, numrin e përfituesve, të ndara këto sipas kategorive familje apo individ, të dhëna mbi fondin e përdorur, të dhëna mbi historikun e aplikimit, të dhëna mbi verifiket e kryera nga ana e administratorit, etj.

Sistemi është në përdorim nga të gjithë përdoruesit e të gjitha njësive vendore në të tre qarqet pilot (Tiranë, Durrës, Elbasan).

Që prej qershorit 2014, pagesat për përfituesit e ndihmës ekonomike përcaktohen automatikisht nga sistemi MIS në bazë të dispozitave të miratuara në ligj. Nëpërmjet sistemit gjenerohen automatikisht listat e përfituesve si edhe borderotë nga financierët e njësive vendore. Nuk bëhen më pagesa të cilat nuk janë të përcaktuara nga sistemi MIS.

Aktualisht në sistem janë rreth 27,000 aplikime aktive prej të cilave rreth 26,000 janë përfitues të ndihmës ekonomike (statistikat për muajin Korrik 2016).

Statusi i fundit i integrimi online të kryera me institucionet e tjera shtetërore janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile: Integrim i plotë
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Integrim i plotë
- Qendra Kombëtare e Regjistrimit: Integrim i plotë
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor: Integrim i plotë
- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme: Integrim i plotë
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit: Integrimi i plotë
- Sistemi i gjykatave: Integrimi funksional në ambientin test.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimtaksave: Integrim i plotë

Ky regjister deri në fund të këtij viti do të shtrihet edhe në 9 qarqet e tjera të vendit.

2.2 Portali elektronik i menaxhimit të burimeve ujore - MMj

ANGAZHIMI: *Ministria e Mjedisit, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të resurseve ujore, do të ndërmarrë krijimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të ujit që do të përmirësojë bashkëpunimin e aktorëve publik dhe privat nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja për aplikimet e licencës dhe kontrollin. Krijimi i një regjistri online të përdoruesve të burimeve ujore do të ndikojë pozitivisht në transparencën.*

STATUSI: PA IMPLEMENTUAR

AKTIVITETET:

Departamenti i Administratës dhe Menaxhimit të burimeve ujore që ishte pjesë e Ministrisë së Mjedisit gjatë hartimit të planit të veprimit kombëtar upërfshirë më vonë në Ministrinë e Bujqësisë, dhe angazhimi nuk ka pasur follow up.

2.3 “Single Window” - DPD

ANGAZHIMI: *Për të lehtësuar dhe përshpejtuar procedurat e shkëmbimeve tregtare në sistemin doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të përqendrojë administrimin e kërkesave dhe procedurave nëpërmjet një dritareje të vetme. Përdorimi i një dritareje të vetme do të zvogëlojë kohën e praktikave administrative, do të zvogëlojë koston dhe në mënyrë të pashmangshme do të sjellë rritjen e nivelit të transparencës.*

STATUSI: NË PROCES

Aktualisht, pritet të nënshkruhet kontrata pas rialokimit të fondeve për tu zbatuar.

AKTIVITETET:

Bazuar në urdhërin e drejtorit të përgjithshëm të doganave është ngritur një grup pune për projektin nën drejtimin e Zv/Drejtorit të Përgjithshëm.

DPD dhe UNECE në periudhën 13 - 17 Qershor 2016 ka organizuar një trajnim për përmirësimin e kapaciteteve të agjencive shtetërore të kontrollit tregtar në Shqipëri për zbatimin e "single ëindoë" me 15 pjesëmarrës.

3.1 Aksesi elektronik për zonat e mbrojtura - MMj

ANGAZHIMI:

Qasja elektronike në një regjistër të zonave të mbrojtura rrit pjesëmarrjen dhe përfshirjen e opinionit publik dhe aktorëve të interesuar për aktivitetet që lidhen me zonat e mbrojtura, zonave të gjuetisë dhe iniciativave kombëtare legislative në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Krijimi i këtij portali do të kontribuojë fuqishëm në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut.

STATUSI: PJESËRISHT I IMPLEMENTUAR

AKTIVITETET:

Është hartuar modeli i bazës së të dhënave template për qasjen elektronike në zonat e mbrojtura, në bashkëpunim me projektin GEF-UNDP-së. Identifikimi dhe krahasimi i informacionit kryesor janë mbledhur në mënyrë që të arrihet një bazë të dhënash e plotë. Modeli është projektuar në mënyrë të tillë që të sigurojë shqyrtimin dhe përditësimin e të dhënave për zonat e mbrojtura.

Kjo bazë të dhënash do të jetë pjesë integrale e portalit të mekanizmit të shkëmbimit të informacionit (CHM - pastrimin mekanizëm shtëpi) për biodiversitetin dhe do të jetë pjesë e portalit Bion dedikuar për biodiversitetin në Shqipëri.

Ndërkohë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura e ka ofruar një listë të tillë elektronike:

http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&id=181:lista-e-zonave-te-mbrojtura&Itemid=477&lang=en

Ai përfshin listën e zonave të mbrojtura për çdo kategori (zona e mbrojtur, park kombëtar, park natyror, monument natyror, etj.), dhe informacion të shkurtër për secilën kategori:
<http://akzm.gov.al/index.php?lang=en>

3.2 Gjeoportali Kombëtar - ASIG

ANGAZHIMI:

Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike, në bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) ka ndërrmarë ndërtimin e Gjeoportalit Elektronik Kombëtar, i cili, për herë të parë, do t'ju siguroj qytetarëve dhe institucioneve, transparencë dhe informacion gjeohapësinor të saktë. Përmes Gjeoportalit Kombëtar qytetarët dhe palët e interesuara mund të aksesojnë hartat topografike, Ortofoton, kufijtë e hartave, hartat treguese e pasurive të patundëshme dhe hartën e vlerës së pronës.

STATUSI: IMPLEMENTUAR

AKTIVITETET:

Gjeoportali Kombëtar mund të aksesohet në linkun e mëposhtëm:

<http://geoportal.asig.gov.al/Default.aspx>

Ai po zgjerohet vazhdimisht me shërbime të reja dhe përmirësim të standardeve teknike.



Figura 2: Imazh i kryefaqes së gjeoportalit <http://geoportal.asig.gov.al/Default.aspx>


ASIG ka publikuar në Gjeoportali të dhënat gjeohapësinore në nivel kombëtar, të cilat janë marrë zyrtarisht nga institucionet publike, për temat të tilla si:

- Ndarjet Administrative
- Vlerat e Tokës
- Ortofoto 2015
- Infrastruktura Rrugore
- Ortofoto 2007
- Informacioni mbi Institucionet Arsimore
- Kadastra
- Gjeologjia
- Harta Topografike
- Përdorimi i Tokës
- Census 2011
- Zonat e Mbrojtura (Natyrore dhe Historike)

Për momentin në Gjeoportalin Kombëtar, mund të aksesohen pa pagesë nga publiku 46 shërbime online të të dhënave Gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë të cilat përfshijnë 2.402 zona kadastrale me 2.2 milion pasuri të paluajtshme ngastra toke, 745,197 ndërtesa dhe 147,776 rrugë me sinjalistikë.

Gjatë gjysmës së parë të 2016, është kontraktuar kompania e cila do të merret me zhvillimin e Gjeoportalit Komëtar në përputhshmëri të plotë me ligjin Nr.72/2012 dhe me Direktivat Europiane për Insrafstrukturën e të Dhënave Gjeohapësinore, INSPIRE. Deri në fundi të vitit 2016 do të implementohen më shumë funksionalitete për publikun si shkarkimi i të dhënave, upgradimi i webmap me më shume funksione që do të lehtësojnë përdorimin, funksionalitet më të avancuar të printimit të hartës, etj.

Vlen për tu përmundur se gjatë vitit 2016 të dhënat nga projekti i fotografimit Ajrorë i Republikës së Shqipërisë, i cili është në vazhdim, si Ortofoto 2015, janë publikuar në Gjeoportali. Gjithashtu është në proces dhe rifreskimi i grupeve të dhënash kryesore si Përdorimit të Tokës, Kadastres, Gjeologjia dhe Zonave të Mbrojtura.



Grafiku 1: Shembull i përdorimit të gjeoportalit gjatë muajit Qershor 2016

3.3 E-Albania - AKSHI

ANGAZHIMI: *Portali e-Albania shërben si një pikë e vetme kontakti për shërbimet qeveritare, duke ndihmuar në përmirësimin e aksesueshmërisë së informacionit për publikun. Platforma e Ndërveprimit, mbi të cilën ky portal është bazuar, mund të zgjerohet për shërbime të tjera qeveritare thelbësore. Qëllimi i këtij angazhimi është kalimi nga shërbimet e nivelit të parë (shërbime informuese) në shërbime të nivelit të tretë dhe të katërt, që nënkupton shërbimet publike të ofruara plotësisht online. Në fund të vitit 2016 pritet të ofrohen tërësisht online 160 shërbime të nivelit të 3 dhe të 4,*

dhe brenda vitit 2017 pritet të shtohen në portalin qeveritar e-Albania 100 shërbime të reja elektronike të nivelit të 3-4.




Figura 3: Imazh i kryefaqes së portalit qeveritar e-albania, <https://e-albania.al/>

STATUSI: IMPLEMENTUAR

AKTIVITETET:

Me qëllim përmirësimin e portalit qeveritar e-Albania, gjatë vitit 2016, janë ndërmarrë projektet (tashmë të përfunduara) si në vijim:

Përmirësimet e portalit qeveritar e-Albania, të cilat konsistojnë në ri-inxhinierimin e portalit në një version të përmirësuar. Versioni i ri është publikuar në vitin 2015. Si rezultat, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Përmirësimi i portalit qeveritar e-Albania;

- Lehtësimi i përdorimit të portalit;
- Përmirësimi vizual i portalit qeveritar;
- Implementimi i infrastrukturës së çelësave publik në portalin e-Albania.al;
- Krijimi i versionit mobile të portalit e-Albania;
- Krijimi i aplikacioneve mobile për Android dhe IOS;
- Implementimi i modulit të pagesës elektronike;

Lidhjet e sistemeve në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit dhe shtimi i shërbimeve të reja në portalin e-Albania. Si rezultat, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Zgjerimi i portalit e-Albania.al duke shtuar shërbime të reja elektronike;
- Përmirësimi i shërbimeve elektronike ekzistuese;
- Publikimi i shërbimeve elektronike në portalin e-Albania.al;

Portali elektronik e-Albania, i riprogramuar dhe i ridizenjuar është funksional. Versioni i ri është përditësuar në funksion të lehtësisë së përdorimit si dhe integritetit të Infrastrukturës së Çelësit Publik, (autenticiteti dhe firma). Website i ri mund të aksesohet nëpërmjet platformave të ndryshme, si PC dhe telefonave celularë, si dhe Android dhe IOS. Në të është integruar gjithashtu dhe moduli i pagesave online.

Lidhur me shtimin e shërbimeve të reja elektronike në portal, përmendim progresin e mëposhtëm:

- Në portalin elektronik e-Albania aktualisht ofrohen 278 shërbime ekzistuese elektronike të nivelit 3-4 si dhe 550 shërbime ekzistuese të nivelit 1 dhe 2, sipas standardeve UNPAN 2014;
- Në portalin elektronik e-Albania parashikohen të shtohen mbi 400 shërbime elektronike në fund të këtij viti.

3.4 E-dokumenti - DPD

ANGAZHIMI:

Format dhe dokumentet që duhen plotësuar për procedura të ndryshme në sistemin doganor nuk janë vetëm të komplikuar, por edhe të shumta. Me synimin për të

lehtësuar aksesin në sistemin doganor do të përdoret e-dokumenti. Jo vetëm që do të lehtësojë përdorimin e formave dhe dokumenteve të ndryshme, por do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi 'paperless'. Ofrimi i shërbimeve publike në mënyrë elektronike përmes e-dokumenteve dhe e-forma do të lehtësojë procedurat për qytetarët dhe biznesin, duke ulur kostot dhe kohën e përdorur për këtë shërbime, gjithashtu do të përmirësojë shkallën e aksesit në informacion për qytetarët duke e bërë procedurat më transparente.

STATUSI: NË PROCES

Lidhur me e-dokumentin, është përfunduar zhvillimi dhe zbatimi i projektit bazuar në doganën 'paperless', i financuar nga Kryeministria përmes AKSHI-t.

Aktualisht po vijon dorëzimi i pajisjeve (skaner + Workstation PC) do të zhvillohet nga AKSHI drejt DPD.

AKTIVITETET:

Ka dy zhvillime paralele:

1. E-dokumenti për sistemin e automatizuar të të dhënave doganore (AYCUDA WORLD), e cila ka të bëjë me përdorimin e certifikimit elektronik. Po koordinohet me AKSHI me qëllim të përmirësimit të legjislacionit për të ofruar këtë shërbim edhe për bizneset.
2. E-dokumenti për qëllime administrative, AKSHI po zhvillon aplikacionin.

4.1 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve - MÇV

ANGAZHIMI:

Aktualisht, besimi i publikut ndaj administratës publike është i ulët, ndërsa rreziku që i kanoset një informatori që denoncon raste të korrupsionit është shumë i lartë. Në Shqipëri, nuk ka një kuadër të qartë i cili siguron bashkëpunim me sinjalizuesit dhe i mbron ato. Ky ligj do të

rrisë jo vetëm transparencën dhe raportimin e rasteve të korrupsionit, por edhe kredibilitetin e administratës.

STATUSI: IMPLEMENTUAR

AKTIVITETET:

Në Maj të vitit 2014, MÇV dhe Ministria e Drejtësisë, me ndihmën e qeverisë holandeze e asistuar nga Universiteti i Utrech-it, filluan hartimin e ligjit "Për mbrojtjen e sinjalizuesve". Ky ligj shërben në rritjen e transparencës së institucioneve publike dhe private, duke krijuar një mjedis më të mirë për punonjësit për të rritur denoncimet e rasteve të korrupsionit.

Projektligji i parë u diskutua në një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura, më 9 Qershor 2014 për të mbledhur reagime nga disa raunde konsultimi me palët e interesuara. Pas tryezës së rrumbullakët me aktorët e interesuar në fund të muajit Shkurt 2015, projektligji u përmirësua më tej dhe pasqyroj jo vetëm sugjerimet që vinin nga shembujt më të mirë ndërkombëtarë dhe homologët shqiptarë, por u përshtat me kontekstin ligjor dhe institucional shqiptar.

Ligji përcakton veprat penale të lidhura me korrupsionin, kompetencat e mekanizmave të brendshëm, dhe identifikon cili organ duhet të shërbejë si mekanizëm i jashtëm raportimi dhe si duhet të sigurohet mbrojtja e sinjalizuesve. Përveç kësaj, ligji vlen si për sektorin publik dhe atw privat.

Ai u miratua në Parlament më 2 Qershor 2016. Me dekretin e Presidentit të Republikës Nr.9647 datë 20.06.2016, ligji u botua në Gazetën Zyrtare Nr.115 më 23 Qershor 2016 dhe hyri në fuqi më 8 Korrik 2016. Efektet ligjore të tij fillojnë nga 1 Tetori 2016, me përjashtim të efekteve ligjore për sinjalizuesit në subjektet private, të cilat fillojnë më 1 Korrik 2017.

Faza e dytë e zbatimit të ligjit pritet të pasohet nga përgatitja e paketës përkatëse të akteve nënligjore, të kombinuar rritje kapacitetesh të institucioneve ligjzbatuese dhe një fushatë kombëtare sensibilizimi. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore është duke përgatitur një sërë veprimesh me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin, në bashkëpunim të ngushtë me ILDKPKI dhe me mbështetjen e organizatës Partners Albania.

Qëllimi i fazës së dytë, atë të zbatimit të ligjit, është të rrisë kapacitetet e njësive të specializuara në menaxhimin e mekanizmin të zbulimit të brendshëm të praktikave korruptive të përcaktuara në ligjin 60/2016 me anë të trajnimeve dhe një programi të veçantë të ASPA bazuar në parimet e ligjit "Për mbrojtjen e sinjalizuesve".

Faza e dytë ka për qëllim gjithashtu në rritjen e ndërgjegjësimit të sektorit privat dhe publik për sinjalizimin e rasteve të korrupsionit dhe zbatimin e ligjit "Për mbrojtjen e sinjalizuesve". Në këtë kuadër, më 25 Korrik, 2016 MÇV në cilësinë e koordinatorit kombëtar, Kryeinspektori i ILDKPKI dhe Partners Albania ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim formalizimin e bashkëpunimit për fazën e dytë të implementimit, në drejtim të luftës kundër korrupsionit, për të vazhduar përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë në promovimin e transparencës, luftën ndaj korrupsionit dhe fuqizimin e qytetarëve.

Në vijim, gjendet përmbledhja e kalendarit të detajuar të të gjitha aktiviteteve të ndjekura në lidhje me angazhimin 4.1:

- Drafti i parë i ligjit, Maj - Qershor 2014. NCAC dhe Ministria e Drejtësisë, me ndihmën e qeverisë holandeze e përfshirë nëpërmjet Universitetit të Utrecht, filloi hartimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve;
- Raundi i parë i konsultimeve publike me pikat fokale në ministritë e linjës dhe komunitetin e donatorëve - Qershor 2014;
- Tryeza e konsultimit me organizatat e shoqërisë civile - Shtator 2014;
- Tryeza e konsultimit me komunitetin e biznesit - Nëntor 2014;
- Projektligji i dytë i përmirësuar në bazë të propozimeve të shkruara të marra nga aktorë të ndryshëm;
- Tryezë e rumbullakët me ministritë përkatëse, shoqërinë civile dhe sektorin privat për të diskutuar draftin e dytë të ligjit në Shkurt 2015;
- Kërkesa për mendime/komente mbi projektligjin e konsoliduar të formës së prerë me të gjitha palët e interesuara - Korrik 2015;

- Projektligji final i përmirësuar është miratuar në Këshillin e Ministrave në Dhjetor 2015;
- Projektligji u diskutua dhe u miratua në parim dhe nen për nen në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut – 29 – 30 Mars, 2016;
- Seanca dëgjimore me të gjithë aktorët, duke përfshirë institucionet e pavarura, OSHC-të, komunitetin i biznesit dhe donatorët ndërkombëtarë - Mars, 2016;
- Projektligji u miratua në Parlament gjatë seancës plenare më 2 qershor 2016;
- Ligji u botua në Fletoren Zyrtare Nr.115 më 23 Qershor 2016 dhe hyri në fuqi më 8 Korrik, 2016;
- Konsultimet e akteve nënligjore dhe caktimi i seancave dëgjimore me të gjitha palët e përfshira është aktualisht në proces.

4.2 Zyrat e Shërbimit të Policisë

ANGAZHIMI:

Qeveria shqiptare me qëllimin për të siguruar dhe për të lehtësuar aksesin në Shërbimin Policor, do të krijojë "one stop shop-e" në çdo qark të policies pwr tw krijuar një tavolinë të unifikuar e pritjes për të gjitha shërbimet e ofruara, thjeshtuar procedurat dhe të kufizuar numrin e dokumenteve që do të paraqitet. Një 'one stop shop' do të përmirësojë dhe të bëjë më efikas bashkëpunimin Polici - Komunitet duke ndihmuar në krijimin e një komuniteti më të sigurt dhe duke rritur pjesëmarrjen e publikut.

STATUSI: I IMPLEMENTUAR

Me qëllim lehtësimin e aksesit në shërbimin policor, rritjen e bashkëpunimit polici-komunitet, rritjen e transparencës, etj, Policia e Shtetit ka implementuar sistemin “Zyrat e Shërbimit për Qytetarët”. Sistemi u vjen në ndihmë qytetarëve për kryerjen e shërbimeve në një zyrë të vetme.

AKTIVITETET:

1. Janë ndërtuar 20 Zyra për Shërbimin e Qytetarëve. Këto zyra janë kompletuar sipas modelit tip të paracaktuar në projekt. Zyrat për Shërbimin e Qytetarëve shtrihen në Drejtorite Vendore të Policisë Tiranë, Lezhë, Berat, Vlorë, Korçë, Fier, Kukës, Durrës, Elbasan, Shkodër, Dibër, Gjirokaster dhe në Komisaritet e Policisë nr. 1, 2, 3, 4, 5 në Tirane, Pogradec, Lushnjë, Kavajë.
2. Është plotësuar struktura organike e parashikuar për shërbimet e Zyrave të Shërbimit të Qytetarëve me 82 punonjës, kryesisht civilë, të cilët ofrojnë shërbime administrative në ZSHQ. Me prioritet janë punësuar kandidatet femra, duke promovuar barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta.
3. Implementimi i Aplikacionit.
 - Aplikacioni i Zyrave të Shërbimit për Qytetarët është sistemi i cili përdoret nga ZSHQ dhe është implementuar në të gjithë zyrat e ndërtuara rishtas.
 - Ky sistem mundëson që qytetarët të aplikojnë për shërbimet në Policinë e Shtetit. Ofrohet një numër i madh shërbimesh për qytetarët.
 - Funksionimi i plotë i aplikimit nuk është realizuar ende për shkak të mungesës së investimeve në rritjen e kapaciteteve të serverit, si dhe përmirësimin e cilësisë së internetit.
 - Sistemi është ndihmë edhe për strukturat e Policisë për të lehtësuar dhe për të monitoruar hallkat e miratimit, aprovimit deri në marrjen e përgjigjes ku kalon shërbimi.
4. Staf i shërbimit në Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve ka ndjekur trajnime të vazhdueshme në disa forma trajnime.
 - Trajnime të detyrueshme janë organizuar një herë në gjashtë muaj për stafin e ZSHQ në Akademinë e Sigurisë.
 - Trajnimet “On–Job” ku me ndihmën e koordinorit të sistemit jepet ndihma për problematika të ndryshme që hasen gjatë dinamikës së punës.

Ky sistem lehtëson procedurat për aplikim për shërbime, monitorimin e hapave që përshkruan aplikimi për kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve, transparencën ndaj publikut për shërbimet që realizohen në policinë e shtetit dhe nxjerrjen e raporteve sipas nevojave. Implementimi i këtij sistemi ka sjellë avantazhet e mëposhtme:

- Kursimin e kohës së qytetarëve për realizimin e shërbimeve të kërkuara.
- Pranimin dhe kryerjen e të gjitha shërbimeve për qytetarët.
- Unifikimin e të dhënave, hapat për miratim, nxjerrjen e raporteve.
- Rritjen e transparencës së punës së policisë.
- Marrjen në kohë reale të informacioneve nga qytetarët.
- Parandalimin e ngjarjeve të mundshme kriminale.
- Reagimin në kohë reale të shërbimeve policore ndaj komunitetit.
- Reduktimin në maksimum të fenomenit të korrupsionit në radhët e Policisë.

Lutemi gjeni më poshtë përmbledhjen e statusit për çdo angazhim:

Nr.	ANGAZHIMI	STATUSI	SFIDA E PHQ
1.1	Standartizimi i procesit të ankesave që lidhen me korrupsionit	<i>Implementuar</i>	Rritja e integritet publik
1.2	Regjistri elektronik i autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve të lëshuara nga MEI	<i>Pjesërisht e implementuar</i>	Rritja e integritet publik
1.3	Implementimi i modulit të pagesave në formatin e të dhënave të hapura	<i>Implementuar</i>	Rritja e integritet publik

1.4	Promovimi i vlerave PHQ tek pushteti vendor	<i>Pjesërisht e implementuar</i>	Rritja e integritet publik
2.1	Krijimi i bazës së të dhënave për ndihmën ekonomike	<i>Implementuar</i>	Menaxhimi më efektiv i burimeve publike
2.2	Portali elektronik për menaxhimin e burimeve ujore	<i>E pa implementuar</i>	Menaxhimi më efektiv i burimeve publike
2.3	“Single Ëindoë”	<i>Në proces</i>	Menaxhimi më efektiv i burimeve publike
3.1	Akses elektronik tek zonat e mbrojtura	<i>Pjesërisht e implementuar</i>	Përmirësimi i shërbimeve publike
3.2	Gjeoportali Kombëtar	<i>Implementuar</i>	Përmirësimi i shërbimeve publike
3.3	E-Albania	<i>Implementuar</i>	Përmirësimi i shërbimeve publike
3.4	E-dokumenti	<i>Në proces</i>	Përmirësimi i shërbimeve publike
4.1	Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve	<i>Implementuar</i>	Krijimi i komuniteteve të sigurta
4.2	Zyrat e Shërbimit të Policisë	<i>Implementuar</i>	Krijimi i komuniteteve të sigurta

3.Përfundimet dhe mësimet e nxjerra

Nëpërmjet zbatimit të PKV të dytë të Shqipërisë, qeveria ka punuar për të forcuar dhe për promovuar një qeveri më efikase, transparente dhe efektive. Qeveria shqiptare ka zbatuar plotësisht shumë nga angazhimet e saj të qeverisjes së hapur, dhe ka bërë progres në angazhimet e tjera gjatë vitit të dytë të zbatimit të planit në krahasim me atë paraardhës.

Pesë rekomandimet kryesore ‘smart’ për vitin 2015 të Mekanizmit të Pavaruar të Raportimit, ishin si më poshtë vijon:

(burimi: Independent Reporting Mechanism (IRM) Progress Report 2014–15: Albania, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf)

1. Krijimi i një forumi të përhershëm të palëve të interesuara dhe një menaxhim më i plotë, të paktën tremujor të monitorimit, dhe raportimit për zbatimin e Planit të dytë të Veprimit.

Më 23 Mars 2016, Shqipëria lançoi Forumin e aktorëve, OpenAlb, një mekanizëm që siguron zbatimin e suksesshëm të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH) në vend. (Shënim: shih seksionin: Përmbledhja ekzekutive)

2. Të ndërmarren angazhime më ambicioze dhe të qenësishme që lidhen me parimet e PQH të cilat të vendosin qytetarët dhe grupet e interesit në një rol ndëreveprues në fushën e antikorrupsionit, duke luftuar mungesën e ndëshkimit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Duhet të krijohen më shumë mundësi për input të drejtpërdrejtë të qytetarëve në funksion të monitorimit, ndërtimit të modeleve për denoncimin e korrupsionit si rasti i portalit unik për denoncimin e tij apo komisarivateve digjitale.

PKV-t i tretë i Shqipërisë përbëhet nga 17 angazhimeve në total, 8 prej të cilave synojnë qeverisje të hapur duke rritur aksesin në informacion, 1 angazhim i cili synon krijimin e komuniteteve më të sigurta, 6 angazhime që synojnë modernizimin e shërbimeve publike dhe 2 me qëllimin për të mbrojtur mjedisin. Rreth 47% (8 nga 17) angazhime janë të përqendruara kryesisht në përfshirjen e qytetarëve.

3. Të promovohen përqasjet për qeverisje të hapur në zhvillimin e reformave kyçe sektoriale dhe iniciativave kombëtare, përfshirë reformën në drejtësi, atë të financimit të partive politike dhe debatin e vazhdueshëm mbi integritetin e zyrtarëve të nivelit të lartë publikë si dhe atyre të zgjedhur.

Parimet e qeverisjes së hapur janë materializuar kohët e fundit në një sërë iniciativash, siç është Ligji për dekriminalizimin i cili u miratua nga parlamenti shqiptar më 17 Dhjetor, 2015. Ky ligj paraqet një hap të rëndësishëm për të reduktuar ndikimin e elementeve kriminale në

vend. Me këtë ligj, përfshirja në institucione politike apo kushtetuese ose emërimi në pozita të larta të administratës publike për 'njerëzit me një të kaluar të errët' shmangen. Ligji dhe ndryshimet e nevojshme kushtetuese në funksion të tij janë miratuar me konsensus, gjë që hap rrugën për zbatimin e menjëhershëm të tij.

Delegacioni i BE në Shqipëri menjëherë pas miratimit të tij theksoi: "Ky hap, pritet të forcojë zbatimin e ligjit, për të përmirësuar integritetin mes zyrtarëve, forcuar luftën kundër korrupsionit, por edhe rritjen e besimit të publikut në funksionimin e shtetit dhe institucioneve".

Efektet e ligjit shtrihen si për të zgjedhurit në parlament dhe në qeverinë lokale. Ai përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha kategoritë e prekura, që nga deputetët, ministrat apo përfaqësuesit e pushtetit lokal, apo zyrtarë të tjerë, duke penalizuar jo vetëm ata që janë dënuar në Shqipëri, por edhe ata që kanë marrë një dënim jo të formës së prerë, në gjykatat e vendeve të Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Kanadasë.

Ligji parashikon një numër të madh penalitetesh zbatimi i të cilave bëhet shkak për të parandaluar ushtrimin e funksioneve publike, si gjatë gjithë jetës ashtu edhe për periudha të ndryshme kohore në varësi të veprës penale. Menjëherë pas miratimit, ambasada e SHBA-ve në Shqipëri shpërnda një deklaratë me të cilën "mirëpret vendimin e guximshëm të parlamentit shqiptar për të miratuar një ligj për dekriminalizimin. Ky ligj, - vijoi Ambasada, - është më i ashpri në Evropë kundër kriminelëve në politikë", duke shtuar se "ky ligj edhe pse rezultat i punës së madhe edhe nga shumica, në fund të fundit, është një fitore për qytetarët shqiptarë që duan një qeverisje të pastër dhe marrjen fund të korrupsionit". Miratimi i këtij ligji u pasua nga një proces i tërë verifikimi të të gjithë nëpunësve publikë subjekt të ligjit, të dhënat e të cilëve janë duke u vlerësuar nga Prokuroria e Përgjithshme.

Një tjetër shembull i mirë i iniciativave të tilla, është reforma në drejtësi, që u miratua unanimisht nga parlamenti shqiptar më 22 Korrik, 2016. Dy qëllimet kryesore të reformës në drejtësi janë: rritja e pavarësisë së sistemit gjyqësor, sidomos nga ndikimi politik, dhe çlirimi i tij nga korrupsioni dhe paaftësia. Reforma e propozuar është një reformë e thellë, e cila ndikon, pa përjashtim, në çdo element të sistemit të drejtësisë. Përveç ndryshimeve në organizimin dhe

funksionimin e sistemit të drejtësisë, reforma përfshin një sërë masash dhe krijimin e institucioneve të përkohshme për të siguruar pastrimin e sistemit aktual nga individë të korruptuar dhe të paaftë.

4. Shoqëria civile duhet të reflektojë përsa i takon PQH dhe të marrë rol më të madh në procesin duke përfshirë sa më shumë angazhime në agjendën kombëtare të PQH për Shqipërinë.

Shoqëria civile është angazhuar në forumin OpenAlb duke qenë kështu e gatshme për të ndarë dhe për të kontribuar dhe po ashtu ka treguar interes në takimet e vazhdueshme për hartimin dhe konsultimin e PKV të tretë i cili është paraqitur tashmë në PQH.

5. T'i kushtohet një buxhet i dedikuar si dhe burime njerëzore Koordinatorit Kombëtar të PQH I cili merret me hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit, si dhe promovimin e agjendës të PQH të Shqipërisë në nivel kombëtar me publikun, aktorët e interesuar, administratën publike dhe komunitetin e donatorëve.

Ende nuk ka një buxhet apo burime njerëzore të dedikuara për PQH brenda strukturës së Koordinatorit Kombëtar të PQH - MIAP.

Rekomandime të tjera të MPM duhet të duhet të përmbushen gjatë zbatimit të PKV-t të tretë të Shqipërisë. Me këto mësimë në mendje, qeveria është e vendosur për të zbatuar me sukses të gjitha angazhimet dhe për të përmirësuar mekanizmin e pjesëmarrës për PKV të ardhshëm.

4. Konsultimi publik

Drafti raporti i vetëvlerësimit i Shqipërisë për Partneritetin për Qeverisje të Hapur për fundin e periudhës, 2014 – 2016, u publikua për konsultim publik në gjuhën shqipe dhe angleze në datën 15 Shtator 2016 përkatësisht në: faqen zyrtare të Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike, <http://www.inovacioni.gov.al/al/prioritete/partneritet-per-qeverisje-te-hapur>, në faqen zyrtare të forumit OpenAlb, <http://openalb.net/per-konsultim-raporti-i-vetevleresimit-te-qeverise-per-planin-e-veprimit-2014-2016/>, si dhe në llogarinë Facebook të Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike, <https://www.facebook.com/milenaharito.al/?fref=ts>.

Drafti raporti qëndroi i publikuar deri në datën 3 Tetor 2016. Nuk pati asnjë koment/sugjerim/mendim nga palët e interesit lidhur me draft raportin e vetëvlerësimit.